URDHËR
Nr. 21, datë 24.1.2022

PËR NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR NË TË GJITHA INSTITUCIONET E ARSIMIT PROFESIONAL PUBLIK DHE JOPUBLIK

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet e arsimit profesional publik dhe jopublik për një periudhë 3 (tri) ditore, duke filluar nga data 24.1.2022–26.1.2022, për shkak të uljes së temperaturave në vlera të konsiderueshme.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe institucionet e arsimit profesional publik dhe jopublik.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj